

**VENDIM**  
**Nr.765, datë 16.11.2006**

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2007, TË ENTIT  
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË LARGIMIT DHE  
PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 11 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2007, për Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, për shumën 20690000 (njëzet milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë) lekësh, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Enti Rregullator i Ujit

Pasqyra nr.1

**PROJEKTPLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2007**

| <b>Nr.</b> | <b>Emërtimi i shpenzimeve</b> | <b>Në 000/lekë</b> |
|------------|-------------------------------|--------------------|
| 1          | Shpenzime për paga            | 12 023             |
| 2          | Sigurime shoqërore            | 2 602              |
| 3          | Shërbime e furnitura          | 5 065              |
| 4          | Investime                     | 1000               |
|            | <b>Totali</b>                 | <b>20 690</b>      |